



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA GJIROKASTËR  
KËSHILLI I BASHKISË  
KRYETARI I KËSHILLIT**

Nr 10745 Prot

Gjirokastër më 8 / 11 / 2023

**Lënda:** Procesverbal i mbledhjes së datës 07.11.2023.

Në zbatim të Ligjit Nr. 139/ 2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe Rregullores së Këshillit Bashkiak po ju vendosim në dispozicion procesverbalin e mbledhjes së datës 07.11.2023

**PROCESVERBAL**

I mbajtur sot në **07.11.2023** në mbledhjen e Këshillit Bashkiak Gjirokastër. Mbledhja po zhvillohet në sallën e Mediatekës pranë Universitetit “Eqrem Çabej”. Mbledhja fillon në orën 12:05 Marrin pjesë në mbledhje 22 anëtarë dhe I bashkohen mbledhjes anëtarë dhe 4 anëtarë, Kore, Qeli, Cacaj, Leskaj. Gjithsej 26 anëtarë.

Mungojnë në mbledhje; Feruni, Rova, Mahmutaj, Kristidhi, Çabeli

Hapet mbledhja nga Znj. Isaraj. Është kuorumi për fillimin e mbledhjes.

Znj. Isaraj paraqet rendin e ditës së bashku me pikën shtesë të propozuar nga ekzekutivi si dhe tërheqjen e pikës 9 për arsye të plotësimit të dokumentacionit.

1. Miratim i procesverbalit të mbledhjes së datës 05.10.2023.

2. P/Vendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike për përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6%, për muajin 01-31.10. 2023”.

3. P/Vendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike për përdorimin e fondit të bashkisë për familjet që do të trajtohen me ndihmë ekonomike për muajin 01-31.10. 2023”.

4. P/Vendim “Për një ndryshim në VKB Nr. 100, datë 16.12.2022 “Për miratimin e PBA 2023-2025 dhe Buxhetit Vjetor 2023”

5. P/Vendim “Për miratimin e kryetarëve të fshatrave të Njësive Administrative të Bashkisë Gjirokastër”.

6. P/Vendim “Për dhënien e titullit të nderit për z. Fatos Sevo Tarifa”

7. P/Vendim “Për dhënien e titullit të nderit për z. Arben Baboçi”.

8. P/Vendim “Për dhënien e autorizimit të propozimit për BID Gjirokasra”.

9. P/Vendim “Për miratimin e përfundimit të procedurave të privatizimit të banesave, të cilat kanë mbetur pa u regjistruar në ZRPP( sot ASHK) për lidhjen e kontratave para noterit”.

10. P/Vendim “Për shprehjen e pëlqimit në parim për dhënien në përdorim të fondit kullosor ndodhur në bashkinë Gjirokastër me qëllim studimin mbi potencialin e energjisë së erës”

11. Raporti i monitirimit të buxhetit për periudhën janar -gusht 2023.

12.Prezantim i rezultateve të monitorimit të shërbimeve publike në lidhje me zbatimin e masave të Eficencës së energjisë dhe Energjisë së Rinovueshme në Bashkinë Gjirokastrë.

13.Prezantim i temës:Ndryshimet Klimatike në rajonin tonë.

14.Të ndryshme.

Z. Aliko: Propozoj që Raporti i monitorimit të buxhetit të kalojë për mbledhjen tjetër, pasi na duhet kohë për ta studiuar.

Znj.Isaraj: Këshilltarët e kanë marrë materialin dhe koha ka qenë e mjaftueshme.

Z. Llogo: Ky është një material që nuk miratohet me vendim, por vjen vetëm si informacion.

Z.Aliko: Këshilli Bashkiak është pronar i pronave të bashkisë Gjirokastrë. Kjo nuk është një letër Buxheti nuk është miratuar ngaky këshill, dhe ne nuk kemi informacion sa është buxheti, sa është shpenzuar .

Miratohet rendi i ditës së bashku me pikën shtesë” Për vendosjen në shtëpinë e të moshuarve” me 23 vota pro dhe 1 kundër.

vota pro.

Miratohet me 24 vota pro procesverbali i mbledhjes së dates 05.10.2023

Hidhen në votë dhe miratohen pikat 2 dhe 3 të rendit të ditës dhe miratohen me 24 vota pro.

P/Vendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike për përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6%, për muajin **01-31.10. 2023**”.

P/Vendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike për përdorimin e fondit të bashkisë për familjet që do të trajtohen me ndihmë ekonomike për muajin **01-31. 10.2023**”.

Z. Aliko: Vendosni si pika kryesore të mbledhjes ndihmën ekonomike, kur ne kemi vetëm 6%. Nuk duhen sjellë në këshill.

Sqaron për këshilltarët znj. Albana Allushi që nëse këto materiale nuk votohen në këshill , qytetarët nuk marrin ndihmën ekonomike.

Kalohet në pikën 4 të rendit të ditës. “Për një ndryshime në vendimin nr 100, datë 16.12.2022 “Për miratimin e programit afatmesëm 2023-2025 dhe buxhetit vjetor 2023”

Z. Brahimi: Do arrini dot për prokurime për të realizuar ndryshimet e parashikuara?

Znj. Artiste Koko sqaron për këshilltarët ndryshimet e parashikuara në buxhet që nuk kanë të bëjnë shumë me prokurimet, por me honoraret e këshilltarëve, aktivitetet dhe ekspertët e jashtëm dhe shumica janë blerje të vogla për Drejtorinë e Shërbimeve Komunale dhe mobilimi I sallës te QKF-ja.

Z. Brahimi: Meqë jemi këtu, ne jemi I vetmi K.Bashkiak pa sallë mbledhjesh që I bëjmë mbledhjet lart e poshtë. A është planifikuar për mbledhjet e këshillit, do ketë foni?

Znj. Artiste Koko; Është planifikuar për sallë mbledhjesh edhe për bashkinë , edhe për Këshillin.

Hidhet në votë dhe miratohet me 23 vota pro dhe 1 kundër, z. Aliko. pika 4 .“Për një ndryshim në VKB Nr. 100, datë 16.12.2022 “Për miratimin e PBA 2023-2025 dhe Buxhetit Vjetor 2023”.

Kalohet te pika 5 .P/Vendim “Për miratimin e kryetarëve të fshatrave të Njësisive Administrative të Bashkisë Gjirokastrë.

Miratohet me 23 vota pro me heqjen e emrit në fshatin Tranoshisht, për arsye se kryeplaku I zgjedhur ka humbur jetën dhe me porosinë që të zgjidhet kryeplaku I ri I fshatit.

Znj.Isaraj paraqet pikat 6 dhe 7 të rendit të ditës për titujt e nderit.

Z. Aliko : E keni zgjeruar shumë dhënien e titujve.

Pas diskutimeve miratohen me 24 vota pro dhënia ë titullit “ Qytetar Nderi” për z. Fatos Sevo Tarifa dhe Z. Arben Kadri Baboçi.

Znj. Isaraj: Kalojmë te pika 8 e rendit të ditës P/Vendim “Për dhënien e autorizimit të propozimit për BID Gjirokasra”.

Sqaron këshilltarët znj. Jorida Muho: Me ligjin nr.63/2020 “ Për përmirësimin e zonave të biznesit (BID) zonat TID , janë kthyer në BID. Siç jeni në dijeni që prej 2017 ka filluar të funksionojë zona TID dhe jeni në dijeni të investimeve, aktiviteteve dhe mbështetjes që TID I ka dhënë zonës së pazarit. Brenda 30 ditëve që nga momenti I miratimit nga ana juaj dhe nëse merr miratimin e 50% të bizneseve ky document merr vlerë dhe bashkia Gjirokastër për vitin erdhshëm financon në vlerën 2 milion lekë.

Z. Llogo : A ka efekte financiare kjo gjë? Kur hyn në zbatim dhe a janë parashikuar ku do gjenden lekët për vitin e ardhshëm?

Z. Aliko: Kur fillon zbatimi I këtij vendimi?

ZNJ. Koko: nuk ka efekte financiare për vitin 2023, por parashikohet që nëse miratohet nga ju dhe 50% e bizneseve për vitin 2024 parashikohen 2 milion lekë. Ka një analizë financiare e cila është e studiuar dhe transformimi nga TID në BID është I mbështetur në ligj.

Z. Llogo: Ai ka bashkia 2 milion lekë dhe nëse bizneset nuk e miratojnë, a bie si VKB?

Znj. Jorida Muho: nëse nuk miratohet nga bizneset patjetër që bie si VKB, por rruga është e miraton këshilli dhe ka 30 ditë kohë të marrë miratimin e bizneseve dhe të vazhdojë me regjistrimin.

Z. Qeli: Nuk jemi kundër, por ta miratoje njëherë biznesi dhe pastaj të vijë në këshill.

Z. Brahimi: Të shtyhet për mbledhjen tjetër që edhe ne të jemi më të qartë.

ZNJ. Muho: Materiali do t ju vijë po I njëjti, sepse nuk ka ndryshime, është hartuar conform ligjit.

Z. Hilaj: Unë mendoj se duhet të sjellë TID një situacion ekonomik, të jemi të informuar pse kjo rritje nga 1 milion në 2 milion .

z. Aliko: Unë në parim e votoj, por duhet më shumë informacion.

Miratohet shtyrja e pikës 8 për një mbledhje të ardhshme .

Kalohet te pika 10 e rendit të ditës: P/Vendim “Për shprehjen e pëlqimit në parim për dhënien në përdorim të fondit kulloror ndodhur në bashkinë Gjirokastër me qëllim studimin mbi potencialin e energjisë së erës”

Sqaron z. Nebi: Ky material është në vazhdim të një vendimi të marrë nga K.B, subjekti bëri studim , por nuk i doli me rezultat pozitiv, dhe kërkon një zonë tjetër për studim e cila është në pronësi të bashkisë Gjirokastër. Nëse studimi I del pozitiv, atëherë vihet përsëri në këshill dhe sipas të gjitha procedurave ligjore për kontraktimin e sipërfaqes.

Miratohet me 24 vota pro P/V “Për shprehjen e pëlqimit në parim për dhënien në përdorim të fondit kulloror ndodhur në bashkinë Gjirokastër me qëllim studimin mbi potencialin e energjisë së erës”.

ZNJ. Isaraj “Kalojmë te raporti i monitorimit të buxhetit për periudhën janar-gusht 2023.

Znj. Koko: Nëse keni pyetje rreth raportit jam gati t’ju përgjigjem.

Z. Brahimi: Taksa e ndriçimit , sa është mbledhur dhe sa ka mbetur pa u mbledhur?

Znj. Koko: Për vitin 2023 është zgjeruar harta e shërbimit, është rritur numri I kontratave nga 135 në 180 kontrata dhe shpenzimet për energjinë janë ulur në masën 52% falë zbatimit të projektit për efikasitetin e energjisë dhe zbatimit të masterplanit edhe në njësitë administrative.

ZNJ. Jorida Muho: Falë projektit të efikasitetit të energjisë kemi filluar me 17 fshatra dhe do shtrihemi në të gjithë fshatrat gradualisht për të realizuar ndriçimin led.

Z. Brahimi: Çfarë investimesh janë kryer me të ardhurat e bashkisë dhe sa% e tyre është realizuar?

Znj. Artiste Koko: Në shpenzime janë realizuar 100%, zbatimi në terren ka të bëjë me çeshtje teknike.

Ka dhe investime që nuk janë mbyllur , që janë me investime nga Pushteti Qëndror.

Janë realizuar 100% realizimi financiar në projektin për përmirësimin e kushteve të banimit, por ka ende çeshtje teknike.

Z. Dashnor Aliko: Kam disa pyetje rreth raportit: Sa % ka investuar bashkia nga të ardhurat e veta?

Sa punonjës janë me kontratë?

Sa është totali i punonjësve të bashkisë Gjirokastër?

Sa është planifikimi buxhetor për Njësinë Administrative Lazarat?

A janë planifikuar dy urat? Janë 630 ha tokë e cila mbetet e bllokuar për shkak të mungesës së urave për të kaluar .

ZNJ. Koko: Nr i punonjësve të bashkisë është 621 ,Nga të ardhurat e veta dhe nga funksionet e deleguara , fondi I pagave zë 52% të buxhetit total dhe 48% zënë shpenzimet për paga nga të ardhurat e veta. Me ndryshimet ligjore të vitit 2017, 2018, 2020, 2022 I gjithë fondi I të ardhurave vendore plos grante konsiderohet një I vëtem.

Nuk është I ndarë buxheti sipas njësive, por sipas kodeve buxhetore në zbatim të ligjit për buxhetin

Znj. Muho:Po, jemi të informuar për 2 urat në Lazarat dhe për vitin në vazhdim i kemi kërkuar ndihmë edhe pushtett qëndror për dy investime të rëndësishme që janë një nga urat dhe rikonstruksioni I shkollës “ Muhamet Gjollesha”.

Z. Brahimi shpreh shqetësimin për investimin që po bëhet te rruga pranë stadiumit.Nuk janë vendosur tabela, firma të punojë natën, të punojë të shtunën dhe të dielën që të mos pengohet lëvizja e qytetarëve.

Znj. Muho: Ky nuk është një investim I bashkisë Gjirokastër, por I Fondit Shqiptar të Zhvillimit dhe disa faza , është në zbatim te Planit të Mobilitetit dhe do të përmirësojë ndjeshëm lëvizjen dhe trefikun në qytet.

Z. Aliko: Dua të di investimet sipas njësive:

Znj. Koko: Ky informacion do t’ju vijë në mbledhjet e ardhshme.

ZNJ Isaraj : Hedhim në votë pikën shtesë “ Për vendosjen në shtëpinë e të moshuarve”.

Miratohet me 19 vota pro .

Vazhdohet me 2 pikat e fundit që kanë të bëjnë me

Prezantim i rezultateve të monitorimit të shërbimeve publike në lidhje me zbatimin e masave të Eficencës së energjisë dhe Energjisë së Rinovueshme në Bashkinë Gjirokastër.

Prezantim i temës:Ndryshimet Klimatike në rajonin tonë. Professor Lavdi Hasani

Të dyja temat u ndoqën me interes nga këshilltarët.

Mbyllet mbledhja nga znj. Isaraj në orën 14:15.

**Sekretar i Këshillit**  
**Etleva Yzo**



**Kryetar i Këshillit**  
**Merita Isaraj**

